



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I MBROJTJES SË KONSUMATORËVE

VENDIM

Nr. 11, Datë 25.10.2010

Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------------|-------------|
| - Z. Besjan Pasha | Kryetar |
| - Znj. Anila Jani | Nënkryetare |
| - Znj. Marsida Xhaferllari | Anëtare |
| - Znj. Ledina Mandia | Anëtare |

Në mbledhjen e tij të datës 25.10.2010, vazhdoi shqyrtimin e ankesës nr. prot. KMK 22, datë 13.09.2010 paraqitur nga universiteti *Justiniani I*, për publicitetin në mediat e shkruara dhe vizive (si edhe në billboard, citylight, etj), në lidhje me ofrimin e programit të studimeve të ciklit të tretë (Doktoraturë), nga ana e Universitetit Evropian i Tiranës.

Komisioni pas shqyrtimit të materialeve përkatëse dhe seancës dëgjimore të zhvilluar me përfaqësuesin e autorizuar të UET dhe përfaqësuesen e Agjencisë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë, në mbledhjen e datës 24.09.2010, si dhe përgjigjes së Ministrisë së Arsimit me shkresë nr. Prot 6101/1, datë 04.10.2010,

VËREN SE:

Në rastin për shqyrtim duhen zbatuar rregullat e Ligjit nr. 9902, datë 17.04.2010 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i cili në nenin 2 të tij parashikon se “Ky ligj përfshin të gjitha llojet e marrëdhënieve ndërmjet tregtarëve dhe konsumatorëve, që kanë të bëjnë me mallrat e konsumatorëve apo shërbime, përveç atyre që parashikohen në dispozitat e ligjeve të veçanta”. Është e vërtetë që Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për arsimin e lartë në RSH”, i ndryshuar, vendos rregulla për arsimin e lartë dhe institucionet e arsimit të lartë privat, mirëpo ky ligj nuk rregullon marrëdhënien “konsumator – tregtar” që në rastin konkret është “student – institucion i arsimit të lartë privat” dhe as praktikant/publicitetet në këto fushë. Për këtë shkak, për këto dy çështje ka fushë zbatimi pikërisht Ligji nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.

Për sa me sipër, Komisioni konstatoi se informacioni në publicitetin në fjalë është i pavertetë dhe për rrjedhojë edhe mashtrues. Kjo praktikë është çorientuese referuar ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve sipas:

- **pikës 1 te nenit 14:** *“Një praktikë tregtare është çorientuese kur përmban informacion të rremë dhe për rrjedhojë është e pavërtetë”*, dhe
- **pikës 1 të nenit 23:** *“Publicitetet çorientues kuptohet çdo publicitet, që në çdo mënyrë, përfshirë dhe paraqitjen e tij, mashtron ose ka mundësi të mashtrojë personat të cilëve u adresohet, ose të cilët i prek dhe që, për shkak të natyrës mashtruese, ndikon ose ka mundësi të ndikojë në interesat ekonomike të konsumatorit dhe, për këto arsye, dëmton ose ka mundësi të dëmtojë një konkurrent”*.

Komisioni konstatoi dhe vlerësoi që pas seancës dëgjimore me përfaqësuesin e autorizuar të UET në mbledhjen e datës 24.09.2010, shkelja në fjale është ndrequr nga ana e UET duke ndryshuar përmbajtjen e publiciteteve në mediat e shkruara dhe vizive në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit 9902 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni mbështetur në nenin 52, pika 1 dhe 4 të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, si dhe në pikën 6 (a) dhe 31 të VKM nr. 1444, datë 22.10.2008

VENDOSI:

1. Pushimin e çështjes për shkelje të dispozitave të Ligjit nr. 9902, dt. 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, ndaj Universiteti Evropian të Tiranës.
2. UET të marre të gjitha masat për mos përsëritjen e praktikave të tilla.

KRYETAR I KOMISIONIT

BESJAN PESHA